

Flamur HOXHA



Datëlindja:20.03.1968

Vendlindja:Kukës

Email:Flamur.Hoxha@parlament.al

Jetëshkrimi:

Flamur Hoxha ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër, në degën Juridik si dhe Master në Shkenca Juridike në po të njëjtin Fakultet.

Është bërë pjesë e lëvizjes së studentëve të dhjetorit 90, me krijimin e Partisë Demokratike, anëtar nismëtar dhe aktivist në degën e Partisë Demokratike Durrës.

Vitet e vështira të emigracionit (1991-1993) i dhanë eksperiencën e duhur për zhvillimin e sipërmarrjes private ku nga 1993 ka drejtuar, menaxhuar dhe zhvilluar një seri biznesesh dhe aktualisht drejton ndërrmarjen e veshjeve KLER shpk Shqipëri dhe KLER SRL në Itali. Që nga viti 2008, themelon kompaninë FB-ART shpk dhe angazhohet në sektorin e ndërtimit.

Ka qenë gjithashtu President i Dhomës Kombëtare të Veshjeve (industria tekstile) 2008-2012 si dhe anëtar i Këshillit Konsultativ të Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë Tregëtisë Enejtitikës (2008-2012).

Krahas ngritjes së kompanive private në fushat e aktivitetit ekonomik është angazhuar gjithashtu në fushën politike si anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike dhe si i ngarkuar i kryesisë së PD-së për riorganizimin e strukturave, në disa degë të Qarkut Tiranë dhe Lezhë. Ka qenë gjithashtu kandidat në zgjedhjet parlamentare të 2017 për Qarkun e Tiranës si dhe Kryetar I Partisë Demokratike Dega Kamëz prej korrikut 2020.